



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 368/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha, Nenad Lazić, Muhamet Rexha dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e paraqitura nga Aleanca Kosova e Re (AKR), Nisma për Kosovën, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të gjitha me seli në Prishtinë dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanicë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Srpska, për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 19.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e subjekteve politike AKR Anr.368/2014, NISMA për Kosovën Anr.369/2014, LDK Anr.370/2014 AAK Anr.371/2014 dhe LVV Anr.372/2014 të datës 17.06.2014, si dhe ankesa subjektit politik PDS Anr. 373/2014 e datës 18.06.2014.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 17.06.2014 ka pranuar ankesat: Anr.368, Anr.369, Anr.370, Anr.371 dhe Anr.372 ndërsa më datë 18.06.2014 ka pranuar ankesën Anr.373/2014.

- Në ankesën - Anr.368/2014 e parashtruar nga subjekti politik AKR në të cilën pretendohet se gjatë numërimit të votave nga diaspora në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është vërejtur se në të gjitha fletëvotimet është votuar nga i njëjti person dhe për të njëjtin kandidat.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur kopjen e librit të votimit

- Në ankesën Anr.369/2014, e parashtruar nga subjekti NISMA për Kosovën në të cilën pretendohet se me datë 17.06.2014 rreth orës 09:00 ka filluar numërimi i votave me postë nga Lista Srpska, vëzhguesit e Nismës për Kosovën dhe vëzhguesit e të gjitha subjekteve tjera kanë vërejtur se fletëvotimet e subjektit Lista Srpska kanë qenë të fotokopjuara dhe të plotësuara nga një person me laps kimik të njëjtë dhe nuk kanë pasur numër serik.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur kopjen e librit të votimit..

- Në ankesën Anr.370/2014, e parashtruar nga subjekti politik LDK në të cilën pretendohet se me datë 17.06.2014 rreth orës 10:00 janë vërejtur parregullsi të

fletëvotimeve të cilat janë të subjektit Lista Srpska, për të cilat parashtruesi i ankesës si janë plotësuar nga i njëjti person dhe vërehen se janë të fotokopjuar. 3/2013.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një deklaratë të nënshkruar nga vëzhguesit e subjekteve të ndryshme politike në QNR siç janë: PDK, LVV, NISMA për Kosovën, AAK, AKR, Koalicija Vakrat, LDK, PAI dhe KDTP..

- Në ankesën Anr.371/2014, e parashtruar nga subjekti politik AAK në të cilën pretendohet se vëzhguesit e saj i akredituar lidhur me keqpërdorimin e votave nga diaspora që i përkasin subjektit politik Lista Srpska, dyshohet se fletëvotimet e këtij subjekti janë plotësuar nga një individ dhe me stilolaps të njëjtë, të formatit A-3 dhe të fotokopjuara.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një deklaratë të nënshkruar nga vëzhguesit e subjekteve të ndryshme politike në QNR siç janë: PDK, LVV, NISMA për Kosovën, AAK, AKR, Koalicija Vakrat, LDK,

- Në ankesën Anr. 372/2014, e parashtruar nga subjekti LVV, në të cilën pretendohet se me datë 17.06.2014 rreth orës 14:00 në QNR vëzhguesit e këtij subjekti gjatë vëzhgimit të procesit të numërimit të fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove, të dërguara me postë kanë vërejtur se fletëvotimet ishin shtypur në letër të formatit A-3 ku shihet se të njëjtat janë plotësuar nga i njëjti person, i njëjti stilolaps dhe për të njëjtin subjekt politik.

- Në ankesën Anr.373/2014 e parashtruar nga subjekti politik PDS në të cilën pretendohet se në bazë të raportit të dorëzuar nga ana e vëzhguesve të akredituar të PDS-së në QNR, lidhur me fletëvotimet me kusht të votuesve jashtë Kosovës, parashtron këtë ankesë për shkak të ekzistimit të dyshimit se këtu ka të bëjë me fletëvotimet të cilat sipas gjitha gjasave janë të nënshkruara nga një apo më shumë persona.

Parashtruesi i ankesës shton se në këto fletëvotime të dyshuara që kanë ardhur nga Republika e Serbisë, është i rumbullakuar i njëjti subjekt politik dhe të njëjtit numra të kandidatëve që gjenden në listën 38 siç janë nr. 5, 14, 39, 44, dhe 47 që tregojnë se një apo më shumë persona kanë administruar gjithë procesin e votimi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 18.06.2014 e informoi Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), për ankesat që janë bërë dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesat, deri me datë 19.06.2014 në ora 09.00.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

Sipas nenit 105.1 të LZP-së, ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, që domethënë se është e lejueshme paraqitja e ankesave të lartpërmendura sipas kësaj dispozite juridike.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “*

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

PZAP-i, për aq sa i është lënë afati ligjor për vendim marrje, ka zhvilluar hetime për të vërtetuar themelësinë e ankesave të lartpërmendura, dhe ka kërkuar paraprakisht nga KQZ-ja të sqarohet për vlefshmërinë e këtyre fletëvotimeve, mirëpo nga përgjigja më shkrim e KQZ-së rezulton se KQZ-ja nuk është lëshuar fare në vlerësimin e rregullsisë së fletëvotimeve në fjalë, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë sikur që ka vepruar me fletëvotimet tjera të parregullta. PZAP-i me qëllim të hetimit të më tejme të rregullsisë dhe vlefshmërisë së këtyre fletëvotimeve, bazuar në nenin 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar dy anëtarë të panelit dhe një hetues kryesor të sekretariatit për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosove që vijnë nga Republika e Serbisë, dhe ky hetim është bërë në QNR. Për ti vërtetuar pretendimet e subjekteve të lartpërmendura lidhur me dyshimet e tyre se fletëvotimet nga votuesit jashtë Kosove janë plotësuar nga i njëjti person, nga i njëjti laps-kimik dhe janë të mbushura e pastaj të fotokopjuara.

Nga i ekipi hetues i PZAP-it, janë hapur gjashtë kuti të fletëvotimeve nga gjashtë komuna të ndryshme siç janë:

- Kutia e Votimit bm126/001 për komunën Vitisë, për Listën Serpska kanë qenë 151 fletëvotime, të cilat ekipi hetues i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 10 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar.
- Kutia e Votimit bm119/02 për komunën e Prishtinës, për Listën Serpska kanë qenë 177 fletëvotime, të cilat ekipi hetues i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 10 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar
- Kutia e Votimit bm106/001 për komunën e Istogut, për Listën Serpska kanë qenë 227 fletëvotime, të cilat ekipi hetuesi i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 13 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar.
- Kutia e Votimit bm112/001 për komunën e Hanit të Elezit, për Listën Serpska kanë qenë 86 fletëvotime, të cilat ekipi hetuesi i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 2 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar.

- Kutia e Votimit bm105/001 për komunën e Dragashit, për Listën Serpska kanë qenë 102 fletëvotime, të cilat ekipi hetuesi i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 8 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar.
- Kutia e Votimit bm114/001 për komunën e Novobërdës, për Listën Serpska kanë qenë 57 fletëvotime, të cilat ekipi hetuesi i PZAP-i, i ka verifikuar një nga një të gjitha, prej të cilave 6 fletëvotime i ka seleksionuar si të dyshimta dhe i ka proceduar për më tej për hetime në panel të zgjeruar.

PZAP-i, nga të gjitha kutit e votimit të hapura nga komunat e ndryshme të lartpërmendura ka verifikuar 800 fletëvotime nga numri i përgjithshëm prej 8551 fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove nga Republika e Serbisë dhe më atë rast nga ky numër i fletëvotimeve të hetuara ka rezultuar se 49 fletëvotime kanë qenë të dyshimta dhe të njëjtat janë proceduar për ti vlerësuar në panel të zgjeruar.

Pas hetimit të fletëvotimeve të dyshimta PZAP-i, ka konstatuar se asnjë fletëvotim nuk ka qenë i fotokopjuar pasi që më parë është plotësuar respektivisht klikuar subjekti politik dhe 5 kandidatët e tij, por ka gjetur se fletëvotimet në fjalë kanë qenë të fotokopjuara e pastaj të plotësuara individualisht me laps-kimik.

Lidhur më pretendimet ankimore se fletëvotimet në fjalë janë fotokopje të formatit “A3”, janë plotësuar nga një person dhe nga i njëjti laps-kimik, nuk qëndrojnë ngase votuesi me zotësi juridike sipas nenit 4.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013, i cili është i regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës, mund ta marr fletëvotimin:

- duke e pranuar fletëvotimin(et) në adresë ekzistuese jashtë Kosovës të cilën ajo ose ai e jep për këtë qëllim, ose,
- duke marr personalisht fletëvotim(et) nga njëra nga pika e shpërndarjes jashtë Kosovës, të përcaktuara edhe të publikuara nga KQZ-ja,
- duke bërë fotokopje fletëvotimin(et) që ekzistojnë nga pikat e shpërndarjes të përcaktuara në 4.1 b të kësaj rregulle, ose
- të shkarkoj fletëvotimin(et) nga ueb faqja e KQZ-së në internet.

Nga kjo dispozitë ligjore del se votuesit jashtë Kosove me të drejtë vote kanë të drejtë ti fotokopjojnë fletëvotimet ku do që gjenden, ti printojnë në forma të ndryshme për sa i përket madhësisë si në formatin A3 apo formatin A4 dhe ti plotësojnë. Poashtu PZAP-i në asnjë rast nuk ka mundur ta vërtetoi se fletëvotimet e plotësuara janë fotokopjuar dhe si të tilla janë dërguar në KQZ. Përndryshe nuk është vërtetuar se këto fletëvotime janë plotësuar nga i njëjti person apo nga i njëjti laps-kimik siç pretendohet në ankesa.

Prandaj bazuar në nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr.368/2014 më datën 19.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.